

# Punonjësi juaj i pavarur rishikues



Broshurë për fëmijë të moshës 12-vjeç e poshtë - Albanian

Kjo broshurë sqaron se si Shërbimi social për fëmijë i Këshillit bashkiak të Kent-it planifikon përkujdesjen ndaj jush dhe se si Punonjësi juaj i Pavarur Rishikues e shikon këtë plan me ju dhe persona të tjerë që punojnë me ju.

## Plani juaj i përkujdesjes

Plani juaj i përkujdesjes tregon se si do t'ju jepet përkujdesje dhe se çfarë do të bëhet që ky plan të funksionojë si duhet.

Plani juaj i përkujdesjes përfshin:

- Kush do të kujdeset për ju
- Shkollën ku do të shkoni
- Gjërat që duhen bërë për të qenë me shëndet të mirë
- Mundësitë për të kryer aktivitete argëtuese, si hobi apo sport
- Kur mund të takoni persona të familjes
- Mundësitë për të praktikuar fenë apo aspekte të kulturës tuaj
- Çfarë do të ndodhë në të ardhmen

Punonjësi juaj social do t'ju dëgjojë me vëmendje dhe do të marrë në konsideratë dëshirat dhe ndjenjat tuaja, opinionet e prindërve tuaj, si dhe do të flasim me persona të tjerë, si p.sh. mësuesit e shkollës ku shkoni.





## Takimi juaj rishikues

Të gjithë personat që kanë të bëjnë me ju duhet të takohen rregullisht. Këta takime quhen takime rishikuese.

## Personat që janë të ftuar në takimin rishikues

Ky takim bëhet për ju, kështu që është e rëndësishme që ju të jeni aty. Personat e tjerë të pranishëm mund të jenë:

- Prindërit apo të afërm të tjerë të familjes
- Kujdestarët
- Punonjësi/punonjësja juaj social/e
- Mesuesi apo mesuesja juaj
- Punonjësi social i kujdestarëve foster
- Kujdestari prind i fëmijës
- Infermieri/infermierja nga shkolla apo e Fëmijëve nën kujdes
- Punonjësi i Pavarur Rishikues (PPR)
- Ndonjë visitor i pavarur përkrahës

Ju mund të flisni me punonjësën social për t'i treguar se kush dëshironi të jetë në takim.



## Sa shpesh do të behen takimet rishikuese?

Takimi i parë do të mbahet brenda katër javëve të para pasi jeni vënë nën kujdesje. Takimi i dytë mbahet jo më vonë se tre muaj pas të parit, dhe pastaj do të ketë një takim çdo gjashtë muaj, për sa kohë të mbeteni nën kujdesje.

## Punonjësi i Pavarur Rishikues (PPR)

Çdo fëmijë dhe adoleshent që është nën përkujdesje duhet të ketë një PPR. Puna e tyre është që të:

- Drejtojnë mbledhjen
- Sigurohen që të gjithë dëgjojnë se çfarë keni për të thënë
- Sigurohen që të gjithë po bëjnë punën e tyre sipas planit
- Sigurohen që ka plane të qarta për të ardhmen tuaj

Gjatë mbledhjes PPR-ja do të dojë të dijë rreth gjërave që kanë shkuar mirë, si dhe rreth problemeve që mund të keni pasur, me qëllim për t'ju ndihmuar dhe përkrahur për zgjidhjen e tyre.

PPR-ja juaj do të dojë t'ju takojë para takimit, për t'ju sqaruar qëllimin e takimit dhe për të dëgjuar opinionet tuaja përpara takimit. Kjo do t'ju japë mundësinë për të treguar se për çfarë doni të flisni, si dhe gjëra që nuk keni dëshirë t'i diskutoni në takim.

## Pjesëmarrja juaj në takimin rishikues

Ju duhet të jeni pjesë e çdo vendimi për të ardhmen tuaj. Nëse e keni të vështirë të flisni gjatë takimit, mund t'í thoni dikujt të flasë në emrin tuaj. Nuk keni nevojë të rrini aty gjatë gjithë takimit dhe mund dilni jashtë në çdo moment.

Në rast se nuk keni dëshirë të merrni pjesë në këtë takim, ju mund të bisedoni me kujdestarin apo punonjësin tuaj social dhe ata do të mund të flasin për ju.

## Përgatitja për takimin rishikues

Përpara takimit juve do t'ju jepet një fletore konsultimi ku mund të shënoni gjërat që doni të thoni. Mund edhe të shkruani një listë apo te dërgoni një tekst për të thënë gjërat që doni të thoni. Nëse doni ta drejtoni ju takimin apo qoftë edhe pjesërisht, punonjësi social apo PPR-ja do t'ju ndihmojnë.

## Pas takimit

Punonjësi juaj social, kujdestari apo PPR-ja do të bisedojnë me ju pas takimit për t'u siguruar që ju e keni kuptuar se çfarë është biseduar dhe vendimet që janë marrë.



## Si të bëni një ankesë?

Në rast se nuk jeni dakord me ndonjë nga vendimet e marra, ju mund të flisni me kujdestarët dhe me punonjësin social, si dhe mund të kontaktoni PPR-në. Nëse përsëri vazhdoni të jeni të pakënaqur, ju mund të bëni ankesë.

Shërbimi për rishqyrtim të pavaruar:

- Veri/Perëndim

Worrall House  
30 Kings Hill Avenue  
West Malling ME19 4AE

Tel: 03000 421543  
email: [IROServiceNW@kent.gov.uk](mailto:IROServiceNW@kent.gov.uk)

- Jug/Lindje

Brook House  
Reeves Way, John Wilson Business Park  
Ēhitstable CT5 3SS

Tel: 03000 421544  
email: [IROServiceSE@kent.gov.uk](mailto:IROServiceSE@kent.gov.uk)

Përkrahës dhe vizitorë të pavarur:

Young Lives Foundation

71 College Road  
Maidstone ME15 6SX

Tel: 01622 683815  
email: [advocacy@ylf.org.uk](mailto:advocacy@ylf.org.uk)



